

STATUTI

I SHOQERISË "VILLA SOL" SH.P.K.

KAPITULLI I EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

NENI 1 EMRI

- Sot në datën 10/08/2017 unë i nënshkruari :
- ❖ **ANDI HODAJ**, datëlindja 28/09/1980, lindur dhe banues në Vlorë, Lagjia "OSMAN HAXHIU", Rruga "DEMOKRACIA", PALLATI 1184 madhor e me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 027790351, Nr personal I00928175R
 - ❖ Vendosa të themeloj Shoqërinë Private, "VILLA SOL", shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shpk, në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Vendosa të hartoj Statutin e Shoqërisë, me përmbajtjen si më poshtë.

NENI 2 FORMA

Kjo Shoqëri është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3 BAZA JURIDIKE

Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Shoqëritë Tregtare", Kodi Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 4 SELIA

Selia e shoqërisë do të jetë Vlorë, Lagjia "OSMAN HAXHIU", Rruga "DEMOKRACIA", PALLATI 1184.

2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakeve.

NENI 5 TERRITORI

Andi Hodaj

Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj. Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë por edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë si më poshtë :

“Shërbime në fushën e hotelerisë dhe turizmit , bar–restorant ,import-eksport , tregtimin me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm ushqimorë, fruta perime, industriale, elektrike, elektronike, pajisje të zyrave, materialeve të ndërtimit, pjesë këmbimi, lëndë drusore, profileve të aluminit, profile të hekurit dhe materialeve plastike të të gjitha llojeve.Prodhimin dhe montimin e vetratave strukturale të dyerve dritareve prej plastike, duralumini, druri, hekuri, përpunime e xhamit etj. Hapjen e agjensive doganore detare spedicionere të informacionit, turistike , omerxhim, pilotim, shërbime të tjera në det etj.Transport mallrash dhe të pasagjerëve . Investime në fushën e ndërtimit.Kryerja e ndërtimeve të të gjitha llojeve.Punimet e armaturave.Përpunimin e hekurit në ndërtim.Punimin e mureve suvatimeve instalimeve hidraulike dhe elektrike.Ndërtimin e rrugëve veprave te artit të përfshira në to,ndërtimin e autostradave,hapjen e kanalizimeve të të gjitha llojeve.Pastrimin e lulishteve si dhe sistemimin e territoreve. Kryerjen e punimeve të ndryshme ndërtimore, objekte social kulturore e banimi, projektimin dhe zbatimin e tyre, rrugë, kanalizime, ura e vepra arti, prodhimin për përdorim e shitjen e materialeve inerte, hapjen e linjave te inerteve, rikonstruksione të çdo lloji. Punime ndërtimi banesa dhe shërbimi në ekonomi”.

Shoqëria mund të bashkpunojë edhe me shoqëri të tjera me objekt të njëjtë ose i ndryshëm nga i saj.

NENI 7 KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë 20 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (deri më 09/08/2037), me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

KAPITULLI II AUTORITETI I ORTAKEVE, LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI

NENI 8 FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKEVE

Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose e humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë si dhe kompetencat që gëzon ortakut në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

NENI 9 LIBRI I SHOQËRISË

Andi Hoda

Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

NENI 10 KONFIDENCIALITETI

Ortaku si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që disponon Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj material, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 11 DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT

Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxirren nga Shoqëria dhe janë të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet, publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "SH.P.K", si dhe emrin e administratorit.

KAPITULLI III KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT DHE TRANSFERIMI I TYRE

NENI 12 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100 000 (NJEQIND MIJE) leke. Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyher nga ortaku . Ky kapital është i ndarë në 1 kuota dhe zotërohet 100 % nga ortaku i vetëm .

NENI 13 KONTRIBUTET

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi i ortakut të vetëm **ANDI HODAJ** i cili është zotëruer i 1 kuota me vlerë 100 000 (NJEQIND MIJE) leke, me 100 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë .

NENI 14 ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para me anë të kontributeve në natyrë ,nëpërmjet emërimit të një eksperti kontabël.

Zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë lejohet nga asambleja e ortakëve ,e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkon ndryshimi i statutit .

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë .

NENI 15 TRASFORMIMI I KAPITALIT

Knotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet :

Andi Hodaj 

-kontributit në kapitalin e shoqëri

-shitblerjes

-trashëgimisë

-dhurimit

-cdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve për sa nuk parashikohet ndryshe në këtë statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

KAPITULLI IV ORGANET DREJTUESE

NENI 16 ORTAKET

Ortakët ushtrojnë të gjitha kompetencat që u njihen me ligj për shkak të kësaj cilësie.

NENI 17 KOMPETENCAT E ORTAKVE

Kompetencat e tyre do të jenë:

1. Vendosin për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqërinë apo për sektorë të veçantë të veprimtarisë.
2. Vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit dhe transferimin e pjesëve të kapitalit.
3. Vendosin për politikën afariste të Shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj.
4. Emëron dhe shkarkon administratorin/administratorët e Shoqërisë dhe detajon kompetencat e tyre të përcaktuara në statut dhe sipas rastit Ekspertin Kontabël.
5. Shqyrtojnë bilancin vjetor, përcakton llojet e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos për marrjen e kredive.
6. Vendosin për krijimin e degëve (filialeve) ose të përfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive me persona të tjerë fizikë apo juridikë.
7. Vendosin për marrëdhëniet më të rëndësishme ekonomike dhe financiare të Shoqërisë me persona të tjerë fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj.
8. Vendosin për mbarimin e Shoqërisë, likuidimin e saj si dhe për shndërrimin e Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera.

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 18 ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

1. Kompetencat e administratorit, në mënyrë konkrete dhe të detajuara përcaktohen në aktin e tyre të emërimit. Veç të tjerave që mund të detajohen në këtë akt, administratori ka edhe këto kompetenca:

1. Realizon administrimin, drejtimin dhe përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhëniet me persona të tjerë juridikë apo fizikë.
2. Kujdeset për funksionimin e përditshëm normal të Shoqërisë ose të një pjese të aktivitetit ekonomik dhe financiar të saj, sipas përcaktimit në aktin e emërimit.

Andi Andri 

3. Përgatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme për gjendjen ekonomike dhe financiare të Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe ia paraqet Ortakëve të Shoqërisë për shqyrtim.
4. Koordinon veprimtarinë e personave të punësuar në Shoqëri.
5. Shqyrton ofertat dhe përgatit kërkesa të cilat ia paraqet Ortakëve të për miratim.
6. Ndjek problemet e Shoqërisë në marrëdhënie me organet shtetërore ose cakton ndonjë prej personelit për trajtimin e këtyre problemeve.
7. I propozon Ortakëve për rregulloret për sektorë të veçantë të Shoqërisë.
8. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.
9. Vendosin çmimet e mallrave dhe shërbimeve .
10. Vendosin për pagat e të punësuarve në Shoqëri.
11. Kompetencat e administratorit janë të pakufizuara.

KAPITULLI V LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDENTET

NENI 19 LIBRAT E SHOQËRISË

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç Librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakëve, kapitali themeltar dhe vendimet e ortakëve edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

NENI 20 BILANCI

1. Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti.
2. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga ortaku i vetëm.
3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 21 DIVIDENTET

Ortaku miraton llogaritë vjetore dhe evidenton ekzistencën e fitimit. Ai përcakton fitimin e vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjane për : rezervën sipas ligjit ose të përcaktuar nga vetë ortaku; fondet e tjera që shihen të nevojshme dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme. Kështu ortaku përcakton dhe dividentin.

KAPITULLI VI MBARIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

NENI 22 MBARIMI

Shoqëria mbaron me vendim të ortakut ose kur ka prishje të parakohshme për arsye të parashikuara në ligj .



**NENI 23
LIKUIDIMI**

1. Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj . Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likuidatorë , të cilët paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin të shoqërisë , mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre .
2. Në fund të procesit të likuidimit , ortaku vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit . Mbas pagimit të kreditorëve ortaku mban pjesën e mbetur të kapitalit .

**KAPITULLI VII
MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA E FUNDIT**

**NENI 24
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

**NENI 25
DISPOZITA E FUNDIT**

1. Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.
2. Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e së cilës do të përcaktohen nga Ortaku i Vetëm.
3. Administratori i shoqërisë është znj. **DARIA KHOTEEVA** .
4. Ajo qëndron në këtë detyrë për një periudhë 5 vjet.
5. Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

**ORTAKU I VETEM
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"VILLA SOL "**

ANDI HODAJ
(emër,mbiemër,firrnë)

